

VENDIM
Nr. 73, datë 14.2.2024

**PËR NJË SHITESË DHE RIALOKIM TË NUMRIT TË PUNONJËSVE
ORGANIKË NË APARATIN E DISA NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE PËR
VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të ministrisë përgjegjëse për financat, miratuar në buxhetin e vitit 2024, reduktohet me 113 (njëqind e trembëdhjetë) punonjës.
 2. Numri i punonjësve të aparatit të ministrisë përgjegjëse për kulturën, miratuar në buxhetin e vitit 2024, reduktohet me 91 (nëntëdhjetë e një) punonjës.
 3. Numri i punonjësve rezervë të buxhetit të miratuar për vitin 2024 reduktohet me 71 (shtatëdhjetë e një) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve rezervë në 29 (njëzet e nëntë) veta.
 4. Numri i punonjësve të përmendur në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, alokohet në aparatin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, kulturën dhe inovacionin, dhe numri i punonjësve për këtë ministri bëhet 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) veta.
 5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku